



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM
Nr. 4 datë 22.1.2020**

**“PËR MIRATIMIN E FORMULARIT TË KËRKESËS PËR TË PËRFITUAR NGA
PROGRAMET E STREHIMIT SOCIAL,,**

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës 22.1.2019, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 55 pika 2, nenit 24 pika 2 të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; nenit 14 pika 2 e ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social“, VKM nr.384 datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfutuar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore“,


VENDOSI:

1. Miratimin e Formularit të kërkesës për të përfutuar nga programet e strehimit social.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar.

Sekretar i Këshillit


Denis Lështa

KRYETARE



KËRKESË

PËR T'U TRAJTUAR ME STREHIM, BAZUAR NE LIGJIN NR. 22/2018,

"PËR STREHIMIN SOCIAL"

FAZA E PARË E APLIKIMIT

Mbiemri _____

Emri _____

Datëlindja _____

Qyteti _____ Nj.Administrative _____ Rruga _____

Nr.Telefoni: _____

I. GJENDJA FAMILJARE

Mbiemri	Emri	Datëlindja (data,muaji,viti)	(1) Seksi	(2) Gjendja Civile	Nr. i dokumentit te identifikimit	(3) Familjarët	(4) Punësimi

1. SEKSI

Mashkull M
Femër F

2. GJENDJA CIVILE

Beqar/e 1
i/e martuar 2
i/e ve 3
i/e divorcuar 4

3. FAMILJARËT

Aplikanti
Nëna/baba
Bashkëshorti/ja
Biri/bija
Gjysh/e
Nip / mbesë
Vjehri/a
Dhëndri/nusja
Vëllai/motra
Kunati/a
Të tjerë

4. PUNËSIMI

00 Punësuar në shtet
01 Punësuar në privat
02 Vetëpunësuar
03 Punësim i rastit
04 I përfshirë në programin e
nd.ekonomike
05 I përfshirë në programin e pagesës së
papunësisë
06 Të tjerë
07

Shënim: Në kolonat 1,2,3 dhe 4 vendos numrin që i korrespondon gjendjes suaj. Të dhënat e kolonës
(3) duhet të korrespondojnë me certifikatën familjare



II. KUSHTET E STREHIMIT

PO JO

2. Disponon banesë në pronësi.....

2.1 Nëse po jep informacionin e saktë mbi :

Prona është e regjistruar në emër të (vendos referencën sipas kolonës (3) të tabelës "Gjendja familjare".....

- Grasoniere.....

- Struktura e apartamentit 1+1

- Struktura e apartamentit 2+1

- Struktura e apartamentit 3+1

- Sipërfaqja totale e banesës dokumentit të pronësisë: _____

- Sipërfaqja totale e banimit: _____

2.2 Nëse jeni përgjigjur negativisht në pikën (2) vazhdoni me plotësimin e informacionit më poshtë:

- Banoj me qira.....

- Banoj me prindërit.....

- Banoj në banesë informale.....

2.3 Kushtet e banimit :

- Kushte të këqija higjieno - shëndetësore.....

- Banesë në rrezik shembje:

- Banese e mbipopulluar:.....

- Kam mbetur i pastrehe si rezultat i fatkeqësive natyrore.....

- Kam mbetur i pastrehë nga procese gjyqësore.....

- Banoj në banesë që prishet dhe përjashtohet nga legalizimi.....



III.KUSHTET FAMILJARE

Shëno vetëm në një kuti që i përshtatet kushtit tuaj familjar:

- 3.1 Familje njëprindërore që kam në ngarkim fëmijë.....
- 3.2 I/E moshuar që kam mbushur moshën e pensionit dhe nuk jam përzgjedhur për t'u strehuar në një institucion publik të përkujdesjes shoqërore.....
- 3.3 Familje më shumë se 4 fëmijë.....
- 3.4 Cift me moshë jo më të madhe se 60 vjeç.....

IV.KUSHTET SOCIALE

Shëno vetëm në një kuti që i përshtatet kushtit tuaj sociale:

- 4.1 Ka në përbërje familjare një individ me aftësi të kufizuara.....
- 4.2 Ka statusin e jetimit dhe me moshë deri në 30 vjeç.....
- 4.3 Ka mbetur i pastrehë për shkak të liritimit të banesës ish-pronarëve.....
- 4.4 Emigrant i rikthyer / punëtor emigrant.....
- 4.5 Azilkërkues.....
- 4.6 Familje e punonjësit të Policisë së Shtetit të rënë në detyrë.....
- 4.7 Punonjës i Repartit të Ndërhyrjes së Shpejtë (FNSH).....
- 4.8 Punonjës i RENEAS.....
- 4.9 Punonjës i Shpëtimit dhe i Mbrojtjes nga Zjarri.....
- 4.10 Viktimë e dhunës në familje.....
- 4.11 Viktimë trafikimit.....
- 4.12 Anëtar i minoritetit Rom.....
- 4.13 Anëtar i minoritetit egjiptian.....
- 4.14 I mitur në konflikt me ligjin
- 4.15 Vajza – nëna.....
- 4.16 Komunitetit LGBTI.....
- 4.17 Anëtar i familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike.....



V. TË ARDHURAT E FAMILJES

Ky seksion duhet të plotësohet për çdo person që siguron një të ardhur në familje në përputhje me kolonat (3) e (4) të tabelës "Gjendja familjare". Në të ardhurat totale të familjes përfshihen të ardhurat neto nga punësimi, dypunësimi, pagesa e papunësisë, pagesa e ndihmës ekonomike , pensioni, dërgesa nga emigracioni, qera nga prona, transferta të tjera nga të afërm, si dhe çdo lloj e ardhure tjetër që sigurohet mbi baza mujore ose vjetore nga trashëgimi, interesa bankare, etj. Me të ardhura neto kuptohen të ardhurat pas shlyerjes së detyrimeve si taksa , tatime e sigurime shoqërore.

- Të ardhura totale mujore të familjes:

.....

- Të dhëna të detajuara të të ardhurave mujore të familjarëve sipas kolonës (3) të tabelës "Gjendja familjare"

00	04.....	08.....
01	05.....	09.....
02	06.....	10.....
03	07.....	11.....

- Të ardhura nga emigracioni(vjetore):

- Të ardhura nga qeraja (mujore):

- Të ardhura të tjera (vjetore):



VI. FORMA E TRAJTIMIT SIPAS NJËRIT PREJ PROGRAMEVE SOCIALE TË STREHIMIT

Unë dhe familja ime kërkoj të trajtohem me strehim nëpërmjet programit të:

(Rendit nga 1 deri në 4, sipas preferencës : 1 për preferencën më të madhe; 4 për atë më të ulët)

- Banesë sociale me qera:
- Përmirësim i banesës.....
- Banesë me kosto të ulët:
- Tokë e pajisur me infrastrukturë për të ndërtuar vetë banesë:

Shënim : Forma e përfitimit mund të ndryshoj nga ajo që ju keni cilësuar si më të preferuarën, në varësi të mundësive të zgjidhjes dhe aftësisë financiare të familjes suaj për të përballuar kostot.

Në mungesë të banesave soaciale me qira dhe në mungesë të banesave me kosto të ulët, njësia e vetëqeverisjes vendore ofron një nga instrumentet e mëposhtme financiare. Nëse ju pranonin, duhet të shënoni:

- | | Pranoj | Nuk pranoj |
|---|--------------------------|--------------------------|
| -Në mungesë të banesave sociale, ofrohet subvencionimi i qirasë në tregun e lirë..... | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |
| -Në mungesë të banesave me kosto të ulë, ofrohet, sipas mundësive buxhetore, subvencionimi i interesave kredive | <input type="checkbox"/> | <input type="checkbox"/> |



VII. DEKLARATË E VËRTETËSISË SË INFORMACIONIT PARAPRAK

DEKLARATË

Nën përgjegjësinë time personale dhe në prani të punonjësit të njësisë se qeverisjes vendore, deklaroj sa më poshtë :

1. I gjithë informacioni i dhënë në formularin KËRKESË PËR TRAJTIM ME STREHIM është i vërtetë.
2. Pranoj që në rast se përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, të bëhet inspektimi në banesën ku banoj dhe verifikimi i gjithë informacionit të dhënë.
3. Jam në dijeni se për çdo informacion të rremë mua dhe anëtarëve të familjes sime u hiqet e drejta për të përfituar strehim.
4. Jam në dijeni se nëse përzgjidhem për t'u trajtuar me strehim, zyra e strehimit në bashki, bazuar në të dhënat mbi të ardhurat familjare , mund të më ofrojë një formë tjetër strehimi nga ajo që kam kërkuar në **KREUN IV** të këtij formulari.

Nënshkruar në: _____ më _____

Deklaruesi : (Emër, mbiemër , firmë) _____



Pt. 2822 13.1.2020



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 100/1 prot.

Shkodër më 5.02.2020

LËNDA: Mbi vendimin nr. 4, datë 22.01.2020 të Këshillit të Bashkisë Shkodër

KËSHILLI BASHKIAK SHKODËR

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, neni 8, shkronja “a”, të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 24, pika 2, të ligjit nr. 22/2018 “Për strehimin social”, neni 14, pika 2, të VKM nr. 384, datë 12.06.2019 “Për caktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, pika 5, shqyrtoi VKB Shkodër nr. 4, dt. 22.01.2020 “Për miratimin e formularit të kërkesës për të përfituar nga programet sociale të strehimit”.

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Çesk MLLJA

